



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 01-060-01-13284-25

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg.

Data / Datum / Date 19.05.2025

OBILIQ - OBILIČ - OBILIC



Republika e Kosovës

Republika Kosovo- Republic of Kosova

Qeveria - Vlada - Government

Komuna Obiliq - Opštine Obilič - Municipality Obiliq

Zyra e Kryetarit të Komunës

Në mbështetje të neneve 12, 14 dhe nenit 58 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 pika 1.3 dhe nenit 11 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019, nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 dhe nenit 23 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 72 paragrafi 1 pika 1.8, nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.I-34 të datës 25.04.2016, Vendimit të Kuvendit Komunal Nr.01-060-01-39212-24 dt.26.12.2024 për Miratim Paraprak të Listës së Përgjithshme dhe Listës së Veçantë të Pronave të Paluajtshme të Komunës që Planifikohen për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë për vitin vijues 2025. Pas negociatave të Kryetarit të Komunës ku të pranishëm kanë qenë Bordi i Drejtorëve si dhe Përfaqësues të Kuvendit Komunal në njërën anë dhe investitori "Nasi Group" SH.P.K. për Njësinë Kadastrale P-72614041-00124-23 zk.Llazarevë e cila është pjesë përbërse e Regjistrit të Pronave Komunale të cilat gjenden në web faqen zyrtare të Komunës, Kuvendi Komunal pas shqyrtimit të Propozimvendimit të Kryetarit të Komunës nr.02-020-01-11097-25, të dt.25.04.2025, si dhe kërkesës nga Kryetari i Komunës nr.02-104-02-10753-25, të dt.23.04.2025, në mbledhjen e mbajtur me dt.16.05.2025 miratoi këtë:

VENDIM

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1

Me këtë Vendim i jepet në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite Investitorit - "Nasi Group" SH.P.K. me adresë: Kryshevc-Rr."Hazir Merlaku" p.n., njësia kadastrale si në vijim:

P-72614041-00124-23, me sipërfaqe të përgjithshme prej 11227m², Vend i quajtur "Harëdhia" zonë -Rrurale, zk.Llazarevë sipas Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale të Komunës, parcela është Zonë Industriale, e evidentuar në Çertifikatën e Pronës në emër të **KOMUNA E OBILIQIT**.

Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave komunale është zhvillimi i aktiviteteve biznesore si dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.

Neni 3

Obligohet Drejtoria për Planifikim Urban, Pronë dhe Kadastër që pas përfundimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të regjistroj në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim afatgjatë në afat prej 99 vitesh.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Planifikim Urban, Pronë dhe Kadastër, Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtoria për Inspektion.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të MAPL-së dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Vendimi është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092, Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe të nenit 72 pika 1.1.8 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.I-34 të datës 25.04.2016.

Kryetari i Komunës duke u bazuar në nenin 11 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019 nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 dhe nenit 23 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës sipas autorizimeve të veta në prani të Bordit të Drejtorëve si dhe Përfaqësuesve të Kuvendit Komunal deputetëve ka negociuar me investitorin "Nasi Group" SH.P.K. me adresë: Kryshevc-Rr."Hazir Merlaku" p.n. sipas kërkesës, Planit ideor dhe sipas Ofertës së negociuar me nr.prot:02-070/05-0010211/25 investitori planifikon që në njësinë e lartëcekur të realizoj investim përkatësisht ndërtimin e Fabrikës për prodhimin e rrjetit të armaturës, konstrukcioneve metalike, pilot për ndërtesa të larta, vlera e investimit është 1.5 milion€. Realizimi i projektit do të bëhet sipas ofertës së negociuar.

Përveç, rritjes së vlerës së Pronës Komunale nga ky projekt do të gjenerohen edhe vende të reja të punës ku përparësi do të kenë banorët e Komunës së Obiliqit.

Andaj me qëllim të realizimit të interesit publik, rritjes së vlerës së pronës publike komunale, krijimit të të hyrave vetanake , ofrimin e kushteve për krijimin e vendeve të reja të punës, përmes bërjes së politikave të punësimit, propozohet dhënia në shfrytëzim e pronës Komunale investitorit të lartëcekur dhe siç përcaktohet në nenin 1 të këtij Vendimi, është miratuar Vendimi.

Kryesuesja e Kuvendit Komunal


Vlora Mjekiqi Kabashi

T'i dërgohet

- Kryetari
- Kryesueses
- DPUKP
- DMM
- DEFZH
- DI
- Palës
- MAPL
- Arkivit

Pjesë e këtij Propozim vendimi është:

- *Certifikata Pronësore ;*
- *Kopja e Planit dhe ;*
- Oferta e Negociuar .*